




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN -
GILAN BELEDIYESI

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim / Direktorat za Zaštitu i Spas / Department of
Protection and Rescue**

Gjiçan, Rr. "Bulevardi i pavarësisë", tel: 0280 320 - 587 0280 320 - 111, e-mail: sami.s.spahiu@rks-gov.net

REFERENC-Ë:	Nr. 11-58/07				
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës - Lutfi Haziri				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Sami Spahiu - Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim				
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raporti gjashtë mujor, Janar- Qershor i punës së Drejtorisë (DMSH) për vitin 2020				
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	09.07.2020
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Datum:	
Room No:		Extencion:		Date:	



Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim aktivitetin e saj zakonisht e bazon në planin e punës të cilën Drejtoria e harton në fillim të çdo viti kalendarik.

Ecuria e punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) mbështetet, në rregulloret dhe ligjet në fuqi, si në Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, me nr: 04/L-027; Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarrëfikje dhe Shpëtim me nr: 04/L-049, Ligjin përkatës Komunal, udhëzimet-rregulloret përkatëse të lëmisë së emergjencave, duke u bazuar në planet e saja të hartuara si Planin e Vlerësimit të Rrezikut, Planin Operativ Emergjent, planet kontingjente etj.

Duke u bazuar në përgjegjësit e saja DMSH, ka marrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe ka përcjellur aktivitetet e subjekteve relevante duke bërë koordinimin varësisht nga karakteri, lloji dhe përmasat e fatkeqësisë – shkallës emergjente.

Aktiviteti i drejtorisë, (që përfshin në vete, Shërbimin e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit, Preventivën-Inspektoratin e SHZSH-së), është në varësi nga faktorët natyrorë por edhe faktorëve tjerë, njerëzorë, teknologjik andaj edhe bëhet sipas intensitetit që përcaktohet nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Fatkeqësisht ky fillim viti e sidomos që nga muaji Mars, ishte më pak i zakonshëm se sa viteve të mëhershme. Andaj edhe fushe veprimtaria e drejtorisë për këtë vitë ishte shumë e veçante.

- Edhe këtë vit, fillim viti është nisur me hartimin e planit të punës për vitin kalendarik 2020. Me kërkesë të AME-së, është hartuar lista e trajnimeve të nevojshme të zyrtarëve me qëllim të shtimit dhe ngritjes profesionale të zyrtarëve dhe stafit të SHZSH-së.
- Pasi që në fillim të muajit Mars të këtij viti, vendi ynë, e në këtë rast edhe Komuna jonë, u godit nga Pandemi virusin 'COVID-19', plani dhe programi paraprak i hartuar i DMSH-së, u bë i

pamundur të realizohet ashtu siq ishte parapar dhe punuar si zakonishtë. Më 18 Mars me vendim të kryetarit të Komunës u formua Komiteti për Menagjim Emergjent, ku pjesë dhe bartëse e shumicës së detyrave të dalura nga ky komitet, edhe për nga natyra e Emergjencës është DMSH-së, dhe faktorëve tjerë përkatës.

- Andaj duke u bazuar në detyrat e këtij Komiteti, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, me të gjitha resurset e saja është angazhuar në menagjimin e kësaj pandemie në komunën tonë, duke e zbatuar të gjitha rekomnadimet e dala nga instancat më të larta shtetrorë gjatë menagjimit Emergjent të situatës në raport me përshkallëzimin e pandemisë.
- Gjatë kësaj periudhe e cila fatkeqësisht vazhdon ende me intetnizitet të rritur, përkundër punës së palodhëshme dhe të vazhdueshme të Komitetit Emergjentë, nën udhëheqjen e Kryetarit z. Lutfi Haziri, DMSH në tërësi, vëzhgon situatën konform situatës gjatë pandemisë, duke u kujdesur për implementimin e urdhëresave të daluar nga Komiteti, IKSH, duke i këshilluar dhe monitoruar qytetarët për masat që duhet zbatuar si domosdoshmëri për tejkalimin sa më të lehtë të situatës së krijuar, gjithënjë me kujdesin më të lartë, që të mos shkaktohet panik dhe frigë tek qytetarët.
- Përkundër kësaj Drejtoria është munduar që të mos mbes mbrapa edhe për punët e tjera të domosdoshme për Komunën, andaj DMSH është marrë dhe ka kryer edhe punë tjera sipas kërkesave të institucioneve të ndryshme. Në Maj të këtij viti kishim një kërkesë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, në fushën e Ujërave lidhur me zhvillimin e Projektit-Vlersimi paraparak i Rrezikut nga Vërshimet në pellgjet Lumore, tek ne me theks të veçantë në Lumin Morava e Binçës. DMSH, ka siguruar të gjithë historiatin e mundëshëm të vërshimeve për gjatë viteve të mëshme, me të dhënat dhe raportet për këto vërshime.
Andaj DMSH si dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, në bazë të dokumenteve, Raporteve zyrtare nga vërshimet të cilat kishin ndodhur në Komunën tonë, dëmet e shkatuara, llojin e dëmëve dhe vlerën e tyre, që nga viti 2000 dhe disa raporte shtesë të para luftës e deri më tani, informuan Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, me dokumente zyrtare të arkivuara në kopje fizike dhe elektronike, si të fotove dhe videoincizimeve të sigurara gjatë periudhave të ndryshme kohore, duke bashkëpunuar edhe me qytetarët e komunës, e sidomos me udhëheqësit e fshatrave. Sipas Ministrisë, projekti ka për qëllim hartimin e një harte e qartë të rrezikshmërisë së vërshimeve, me të dhëna të sakta, që në të ardhmen të mundësohet një planifikim më i saktë dhe efikas për mbrojtje nga vërshimet e mundëshme të lumenjëve në Kosovë, ku në kuadër të saj është edhe Komuna e Gjilanit lumi Morava e Binçës me pellgjet.
- Gjatë këtyre muajve DMSH në kordinimin NjPZSh, ka kontribuar vazhdimisht në dezinfektimin e objekteve institucionale, por edhe atyre private ku ka pasur qarkullim të njerëzve, me qëllim të uljes së rrezikut dhe mundësisë përhapjes të infektimit të qytetarëve me Covid 19.
- Krahas kësaj NjPZSh, ka vazhduar punën në nivelin më të lartë të përgjegjësisë në rastet e intervenimeve të ndryshme si shpërthimeve të zjarrev si në qytet ashtu edhe në fshatrat për rrethë.
- Meqenese tani kemi hyrë në fazën e muajve të nxehtë, DMSH-ka ndërmarrë masat e parapara sipas planit të paraparë vjetor në sensibilizimin dhe thirrjen tek qytetarët për kujdes ndaj zjarreve. Sipas palni është bërë shpërndarje fizike e afisheve në vendet publike në fshatara dhe qytet, nëprmes mjeteve të informimit, portaleve dhe rrjeteve sociale, duke bërë thirrje për kujdes të

shtuar të qytetarëve në raport me zjarrin dhe zjarret gjatë sezonin verorë në kohën e temperaturave të larta.

- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në vazhdimësi bën dhe implementon detyrat e saja konformë dispozitave ligjore, por edhe tani është e mobilizuar dhe mbi baza ditore bënë kujdestarin në qendrën operative emergjente komunale dhe gjithashtu bënë monitorimin e zbatimit të masave kundër Covid-19, gjithashtu.

Nga rapori i daljeve NJPZSH-ës,
PASQYTRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE: **JANAR - QERSHOR 2020**

2020	Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarrë në Autom.	Gjith.
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Paisjet shpërndarse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera	Automjete motorrike	
Janar	1	2	0	0	10	0	0	1	0	0	0	2	0	0	0	2	0	8	2	28
Shkurt	1	1	1	1	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	11	0	10	0	31
Mars	3	0	1	0	3	0	0	2	0	0	0	0	0	0	11	8	0	12	3	43
Prill	5	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	29	7	0	23	1	68
Maj	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	4	0	1	2	1	0	6	1	18
Qershor	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0	4	0	4	2	15
Korrik																				
Gusht																				
Shtator																				
Tetor																				
Nëntor																				
Dhjetor																				
Gjithsejtë	12	3	3	1	21	2	0	3	0	0	0	8	0	1	44	33	0	8	9	203